

## MBI NDËRHYRJET NË TREGUN E PARASË DHE NË TREGUN VALUTOR GJATË TREMUJORIT TË KATËRT TË VITIT 2010

### 1. Ndërhyrjet e Bankës së Shqipërisë në tregun e parasë gjatë tremujorit të katërt të vitit 2010

Tabelë 1: Vëllimi i operacioneve të përkohshme të tregut të hapur  
(në milionë lekë<sup>1</sup>).

DATA	R/REPO njëjavore me çmim variabël	R/REPO mujore	R/REPO tremujore
30.09.2010	14,400.00	3,000.00	
07.10.2010	7,810.00		
14.10.2010	9,900.00	3,000.00	
21.10.2010	14,000.00	2,000.00	
28.10.2010	16,800.00	2,000.00	
04.11.2010	8,770.00		2,000.00
11.11.2010	7,880.00		2,000.00
18.11.2010	6,900.00		
25.11.2010	14,300.00		
02.12.2010	11,500.00		
09.12.2010	9,250.00		
16.12.2010	8,800.00		
23.12.2010	4,880.00		
30.12.2010	9,900.00		

#### 1.1 Operacionet e tregut të hapur

Ndërhyrjet në tregun e parasë gjatë tremujorit të katërt të vitit 2010 përfshijnë operacione të tregut të hapur për injektimin e likuiditetit.

Për injektimin e likuiditetit, Banka e Shqipërisë përdori instrumentin e saj kryesor, marrëveshjen e anasjelltë të riblerjes me maturim njëjavor, mesatarisht 10.36 miliardë lekë<sup>1</sup> në javë si dhe instrumentet rregulluese me maturim më të gjatë se një javë - marrëveshjen e riblerjes me maturim një dhe tremujor. Marrëveshja e anasjelltë e

riblerjes me maturim njëmuor u përdor në 4 raste, mesatarisht 2.5 miliardë lekë për ankand. Përdorimi i marrëveshjes së anasjelltë të riblerjes me maturim tremujor ka vijuar të jetë i pranishëm, por në raste dhe sasi më të reduktuara. Në

<sup>1</sup> Shifrat janë të shprehura në vlerë nominale.

fillim të muajit nëntor, janë kryer 2 ankande me vlerë nominale 2.00 miliardë lekë për ankand.


## 1.2 Përdorimi i instrumenteve mbështetëse

Gjatë tremujorit të fundit të vitit 2010, depozita njëditore u përdor në 32 raste, mesatarisht 0.71 miliardë lekë, gati 0.23 miliardë lekë më shumë se tremujorin e kaluar, kur ky instrument është përdorur në 27 raste. Edhe gjatë këtij tremujori, përdorimi i depozitës njëditore ishte më intensiv gjatë ditëve të fundit të periudhës së mbajtjes së rezervës së detyruar.

Instrumenti i kredisë njëditore është përdorur në 5 raste mesatarisht 0.71 miliardë lekë, kundrejt 18 rasteve të tremujorit të kaluar me një mesatare prej 0.89 miliardë lekësh.

Grafiku i mëposhtëm paraqet në mënyrë të përmblendhur ndërhyrjet e Bankës së Shqipërisë në tregun e parasë për vitin 2010.

**Grafik 1:** Ndërhyrjet e Bankës së Shqipërisë në tregun e parasë gjatë vitit 2010 (me çmim blerjeje).



## 2. Ndërhyrjet e Bankës së Shqipërisë në tregun e brendshëm valutor gjatë tremujorit të katërt të vitit 2010

### 2.1 Veprime me bankat e nivelit të dytë

Pas blerjeve të valutës në masën 1,597.63 milionë lekë gjatë tremujorit të tretë, Banka e Shqipërisë ka ndërhyrë në tregun e brendshëm valutor në tremujorin e fundit të vitit në kahun e blerjes së valutës, duke pasur si objektiv rritjen e rezervës valutore. Si rezultat i ndërhyrjes, janë shitur 304.15 milionë lekë.

### 2.2 Veprime me institucione të tjera

Gjatë kësaj periudhe, kanë vijuar të realizohen veprime të shitjes dhe të blerjes së valutës me Ministrinë e Financave. Blerjet nga Ministria e Financave qenë 18,135.80 milionë lekë, ndërsa shitjet 18,218.23 milionë lekë.

Blerjet e valutës nga institucionet e huaja llogariten në 100.22 milionë lekë (Agjencia Ndërkombëtare për Zhvillim – IDA dhe Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim - IBRD).

Institucioni financiar	Blerje të valutës (në milionë lekë)	Shitje të valutës (në milionë lekë)
MINISTRIA E FINANCAVE	18,135.80	18,218.23
TË TJERA (IDA, IBRD)	100.22	